



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA E ZHVILLIMIT TË POLITIKAVE DHE PROGRAMEVE TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR

Nr. 2591/2 Prot.

Tiranë, më 24.04, 2025

Lënda: Për njohje dhe zbatim.

AGJENCISË KOMBËTARE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR ✓

Rr. "Aleksandër Moisiu", përballë IKV, Tiranë

AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR

Rr. "Naim Frashëri", Tiranë

QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE

Blvd. "Zhan D'Ark", Tiranë

Bashkëlidhur, gjeni për njohje dhe zbatim urdhrin e përbashkët nr. 156, datë 22.04.2025 "Për miratimin e strukturës së vitit shkollor 2025-2026 në sistemin arsimor parauniversitar".

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Erzen Tola





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Nr. 2591 prot. datë 22.04.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË,
KULTURËS DHE INOVACIONIT

Nr. 4849/2 prot. datë 14.4.2025

URDHËR I PËRBASHKËT

Nr. 156, datë 22.04.2025

PËR

**MIRATIMIN E STRUKTURËS SË VITIT SHKOLLOR 2025 – 2026
NË SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 26 të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7 të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

U R D H Ë R O J M Ë:

Struktura e vitit shkollor 2025-2026 të jetë si më poshtë:

1. Në arsimin bazë:
 - a) Mësimet fillojnë më 8 shtator 2025 dhe mbarojnë më 12 qershor 2026;
 - b) Pushimet fillojnë më 22 dhjetor 2025 dhe mbarojnë më 2 janar 2026;
 - c) Pushimet fillojnë më 30 mars 2026 dhe mbarojnë më 3 prill 2026;
 - ç) Provimet kombëtare të arsimit bazë zhvillohen në periudhën 15-26 qershor 2026;
2. Në arsimin e mesëm të lartë:
 - a) Mësimet fillojnë më 8 shtator 2025 dhe mbarojnë më 12 qershor 2026;
 - b) Për maturat, mësimet fillojnë më 8 shtator 2025 dhe mbarojnë më 29 maj 2026;
 - c) Pushimet fillojnë më 22 dhjetor 2025 dhe mbarojnë më 2 janar 2026;
 - ç) Provimet e Maturës Shtetërore zhvillohen në periudhën 1-26 qershor 2026;
3. Në arsimin profesional:
 - a) Mësimet fillojnë më 8 shtator 2025;
 - b) Për nxënësit e klasave të 10-ta për të gjitha strukturat, nxënësit e klasave të 12-ta për strukturën, 2+2 si dhe për nxënësit e klasave të 11-ta dhe të 12-ta për strukturën 4-vjeçare, mësimet mbarojnë më 12 qershor 2026;
 - c) Për nxënësit e klasave të 11-ta dhe të 12-ta për strukturën 2+1+1 dhe për nxënësit e klasave të 11-ta për strukturën 2+2, mësimet mbarojnë më 29 maj 2026;

- ç) Për të gjithë nxënësit maturantë, mësimet mbarojnë më 15 maj 2026;
 - d) Pushimet fillojnë më 22 dhjetor 2025 dhe mbarojnë më 2 janar 2026;
 - dh) Provimet përfundimtare për kualifikimet profesionale të Nivelit II dhe III të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KShK) zhvillohen në periudhën 1-12 qershor 2026;
 - e) Provimet përfundimtare të praktikës profesionale të kualifikimeve profesionale të Nivelit IV të KShK-së zhvillohen në periudhën 25-29 maj 2026;
 - ë) Provimet e Maturës Shtetërore Profesionale zhvillohen në periudhën 1-26 qershor 2026;
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhri, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe të gjitha institucionet arsimore të sistemit arsimor parauniversitar.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT

DHE SPORTIT

OGERTA MANASTIRLIU



MINISTRI I EKONOMISË,

KULTURËS DHE INOVACIONIT

BLENDI GONXHJA

